



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201302622/12

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Përsërisim rekomandimin për propozimin për miratim të projektligjit: "Për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe plotësimin të nevojave për moshën e tretë".*

Drejtuar : **Z. Blendi KLOSI**
Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

TIRANË

I nderuar zoti Ministër,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, Shoqata për Integrim e Pensionistëve të Shqipërisë, ka paraqitur ankesë për mosmiratimin e statusit të moshës së tretë.

Ju vemë në dijeni se për këtë çështje, institucioni ynë, më herët ka kryer një korrespondencë me ish-Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Konkretisht:

-Me shkresën nr.374/1 datë 25.02.2013, nga ana e ish-MPÇSSHB-së, na është kthyer përgjigje, ku ndër të tjera na konfirmohej fakti se në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe grupet e interesit, po punohej për hartimin e projekt-ligjit "*Për kujdesin e personave të moshës së tretë*", i cili ishte parashikuar të miratohej brenda vitit 2013.

-Me shkresën nr. 2653/1 datë 20.12.2013, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë na informon se në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2013, është parashikuar miratimi i projekt-ligjit për moshimin "*Përmirësimi i cilësisë së jetesës dhe plotësimi i nevojave për moshën e tretë*", ku me Urdhër të Ministrit është ngritur grupi i punës ndërministror për hartimin e këtij projektligji. Është përgatitur projektligji dhe relacioni përkatës. Kostoja financiare është e lartë dhe po rishqyrtohet edhe njëherë me Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Financave për miratimin e këtij projektligji për vitin në vazhdimësi.

-Me shkresën nr.3726/1 datë 24.07.2014, na është kthyer përgjigje se Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ka ndërmarrë edhe realizimin e reformës së pensioneve në Republikën e Shqipërisë, ku një ndër masat kryesore që synon realizimin e kësaj reforme është pensioni social, masë e cila është parashikuar edhe në projektligjin e sipërcituar. Në kushtet që të dyja reformat kërkojnë një harmonizim të projektakteve ligjore të parashikuara në VKM nr.20 datë 22.01.2014 “Programi i përgjithshëm analitik i projektakteve për vitin 2014”, është kërkuar rivlerësimi i projektligjit “Përmirësimi i cilësisë së jetesës dhe plotësimi i nevojave për moshën e tretë” si dhe është propozuar që ky projektligj të parashikohet në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2015.

Duke i parë problemet e kësaj moshe me objektivitet, duhet pranuar dhe kuptuar fakti se situata e të moshuarve në Shqipëri nuk është e mirë. Ato përbëjnë një ndër grupimet më të mëdha numerike të shtresave dhe grupeve në nevojë. Mungesa e sigurimit të një minimumi të ardhurash, mund t’i çojë të moshuarit dhe familjet e tyre në varfëri. Ata ndeshen shpesh me barrierat shoqërore që ndikojnë në jetët e tyre.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 59, pika 1/ “e”, ka përcaktuar si objektiva sociale të shtetit, edhe :

“e. përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët, ”

Për sa më sipër, me qëllim që të moshuarit të kenë të drejtat e tyre, në përmbushje të objektivave sociale dhe ekonomike, realizimi i të cilave është i lidhur ngushtësisht me detyrimin e shtetit për të bërë të mundur garantimin dhe sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”,*

REKOMANDOJMË:

Propozimin për miratim të projektligjit “Për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe plotësimin të nevojave për moshën e tretë”.

Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet të shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

